

## MARREVESHJE SHITBLERJE KUOTASH

Sot më 01.05.2018, palët e mëposhtme, kanë lidhur marrëveshjen e mëposhtme të shitblerjes së kuotave ("**Marrëveshja**"):

*Nga njëra anë.*

**Z. Ergi Angoni**, shtetas shqiptar, i lindur më 06.06.1990, në Gjirokastrë, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. 033005753, madhor dhe me zotësi të plota juridike për të vepruar, vepron në cilësinë e ortakut të vetëm që zotëron 100% të kapitalit të shoqërisë NRG PLUS SHPK, me NUIS L81501016E dhe seli në Autostradën Tiranë – Durrës, Km. 6, Kompleksi Usluga, Kashar, Tiranë, Shqipëri ("**Shoqëria**") (në vijim referuar si "**Shitësi**").

*Nga ana tjetër:*

**Z. Genti Jaupi**, shtetas shqiptar, i lindur më 18.10.1977, në Tiranë, mbajtës i pasaportes me nr. H71018032F, madhor dhe me zotësi të plota juridike për të vepruar, (në vijim referuar si "**Blerësi**")

Shitësi dhe Blerësi në vijim janë referuar si "**Palët**" dhe secili prej tyre si "**Pala**".

### HYRJE:

- A) Shitësi zotëron një kuotë që përfaqëson 100% të kapitalit themeltar të "NRG PLUS" SHPK, një shoqëri shqiptare me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar rregullisht dhe e organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, me NUIS L81501016E dhe seli në Autostradën Tiranë – Durrës, Km. 6, Kompleksi Usluga, Kashar, Tiranë, Shqipëri, me një kapital prej 100 Lekë (në vijim referuar si "**Shoqëria**");
- B) Shitësi ka rënë dakord të shesë, dhe Blerësi ka rënë dakord të blejë, Kuotat në Shitje sipas Kushteve dhe afateve të kësaj marrëveshje ("**Marrëveshja**").


*ËSHTË RËNË DAKORD SI ME POSHTË:*

### 1. OBJEKTI I MARRËVESHJES

1.1 Sipas kushteve dhe afateve të kësaj Marrëveshjeje, Shitësi do t'i shesë dhe transferojë në mënyrë të pakthyeshme me pronësi të plotë Blerësit, dhe Blerësi do të blejë nga Shitësi Kuotat në Shitje në Shoqëri, të pa barrësuar, si shpërblim me Çmimin e Blerjes, përfshirë të gjithë titujt e të drejtëve, përfitimet dhe interesat e Shitësit dhe për Kuotat në Shitje si dividendet, shpërndarjet, ose cdo kthim të kapitalit të deklaruar dhe/ose të përllogaritur për Kuotat në Shitje.

### 2. ÇMIMI I BLERJES

2.1 Si shpërblim për shitjen dhe transferimin e Kuotave të Shitjes, Blerësi ka rënë dakord dhe do t'i paguajë Shitësit, Çmimin e Blerjes prej 10,000 Lekë (dhjetë mijë) ("**Çmimi i Blerjes**")



2.2 Çmimi i Blerjes do t'i paguhet Shitësit plotësisht me nënshkrimin e kësaj Marrëveshje

### 3. TRANSFERIMI EFEKTIV I KUOTAVE TË SHITJES

- 3.1 Pronësia e Kuotave të Shitjes me të gjitha të drejtat bashkëngjitur i transferohet Blerësit i cili do të konsiderohet me të drejta të plotë si ortak i vetëm i Shoqërisë më 1 maj 2018 ("Data e Transferimit").
- 3.2 Transferimi i Kuotave do të bëhet në përputhje me Ligjet e zbatueshme në Shqipëri.

### 4. ANGAZHIMET E PALËVE

- 4.1 Shitësi dhe Blerësi do të nënshkruajnë dhe dorëzojnë çdo dokument dhe kryejnë veprimet e mëtejshme të cilat janë në formën dhe thelbin e pranuar nga Regjistri Tregtar në mënyrë që të publikojnë këtë Marrëveshje dhe transaksionin e parashikuar në këtë Marrëveshje.
- 4.2 Shitësi autorizon Blerësin për të kryer të gjitha ato veprime dhe gjëra në emër të Shitësit që Blerësi i konsideron të nevojshme ose të përshtatshme për regjistrimin e shitjes dhe blerjes së Kuotave të Shitjes në Regjistrin Tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit të Republikës së Shqipërisë.

### 5. KOSTOT

- 5.1 Secila Palë në këtë Marrëveshje do të paguajë shpenzimet dhe kostot e saj të kryera në lidhje me përgatitjen dhe negocimin e kësaj Marrëveshjeje.
- 5.2 Çdo transferim ose taksë e pulles (duke përfshirë por jo vetëm tarifen e noterit) që duhet të paguhet si rrjedhojë e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje dhe transferimit të Kuotave të Shitjes do të ndahet dhe paguhet në mënyrë të barabartë midis Blerësit dhe Shitësit.

### 6. DISPOZITA TË NDRYSHME

- 6.1 **Marrëveshja në tërësi:** Kjo Marrëveshje dhe të gjitha dokumentet e dorëzuara si pjesë e ose të rastësishme për këtë Marrëveshje ose të cilat janë të përfshira si pjesë të kësaj Marrëveshjeje sipas referencës, përbëjnë dhe përmbajnë të gjithë Marrëveshjen midis Palëve dhe kanë përparësi mbi ndonjë dhe të gjitha kontratat, angazhimet dhe marrëveshjet midis Palëve në lidhje me objektin e kësaj Marrëveshjeje.
- 6.2 **Ndryshimi:** Asnjë ndryshim, modifikim ose rregullim i kësaj Marrëveshjeje nuk do të jete i vlefshëm përveçse nëse bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga secila Palë. Nëse në ndonjë kohë ndonjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje është ose bëhet e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme atëherë kjo dispozitë do të konsiderohet si e ndarë nga kjo Marrëveshje dhe nëse është e mundur do të zëvendësohet nga një dispozitë e ligjshme që përmbush qëllimin e Palëve sipas kësaj Marrëveshjeje dhe nuk do të prekë ose çënojë vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e ndonjë dispozite tjetër të Marrëveshjes.
- 6.3 **Transferimi:** Asnjëra Palë nuk do të ketë të drejtë të transferojë ose kalojë në ndonjë mënyrë tjetër ndonjë ose të gjitha të drejtat ose detyrimet e tyre përkatëse sipas kësaj Marrëveshjeje të një person përveçse me miratimin paraprak me shkrim të Palës tjetër në këtë Marrëveshje.




6.4 **Njoftimet:** Cdo njoftim, kërkesë ose komunikim tjetër që do të jepet ose bëhet sipas kësaj Marrëveshjeje do të jetë me shkrim në gjuhën angleze. Përveçse kur parashikohet në këtë Marrëveshje ky njoftim, kërkesë ose komunikim tjetër do të konsiderohet të jetë dhënë ose bërë rregullisht kur jepet dorazi, me korrier ose i dërgohet me email palës së cilës kërkohet ose lejohet ti jepet ose bëhet në adresën e palës, që kjo e fundit cakton nëpër njoftimit të palës tjetër të cilës i jep ose i bën këtë njoftim, kërkesë ose komunikim tjetër.


6.5 **Ligji rregullues dhe Juridiksioni:** Kjo marrëveshje do të rregullohet dhe interpretohet sipas dhe në zbatim të ligjit Shqiptar, duke përjashtuar mospajtueshmërinë e rregullave ligjore. Cdo mosmarrëveshje që lind ose në lidhje me këtë Marrëveshje ose që lidhet me të ose që ka të bëjë me zbatueshmërinë ose vlefshmërinë e saj do të zgjidhet përfundimisht nga Gjykatat përkatëse Shqipëtare.

6.6 **Gjuha dhe Kopjet:** Kjo Marrëveshje do të nënshkruhet dhe mbahet në tre kopje identike në gjuhën Shqipe.

Z. Ergi Angoni

Z. Genti Jaupi

  
(emri, mbiemri, nënshkrimi)

  
(emri, mbiemri, nënshkrimi)

